



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2024/1250

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Vedat Poterqoi - Kryetar, duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) N.P.N. "UNIVERS- MI", kundër Vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit të MINISTRIA E SHËNDETËSISË në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit “Mbikëqyrja profesionale e ndërtimit te QKMF ne Istog dhe QKMF ne Drenas” me numër të prokurimit 206-24-6057-2-2-1, me 10/02/2025, mori:

Vendim

1. Aprovohet, si pjesërisht e bazuar ankesa e OE N.P.N. "UNIVERS- MI" me nr. 2024/1250, e datës 20/12/2024, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Mbikëqyrja profesionale e ndërtimit te QKMF ne Istog dhe QKMF ne Drenas” me numër të prokurimit 206-24-6057-2-2-1.

2. Mbetet në fuqi, Njoftimi mbi Vendimin e AK të MINISTRIA E SHËNDETËSISË, ndërkaq aktiviteti i prokurimit “Mbikëqyrja profesionale e ndërtimit te QKMF ne Istog dhe QKMF ne Drenas” me numër të prokurimit 206-24-6057-2-2-1.

3. Bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 18.06.2024, MINISTRIA E SHËNDETËSISË në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me “Mbikëqyrja profesionale e ndërtimit te QKMF ne Istog dhe QKMF ne Drenas” me nr. të prokurimit: 206-24-6057-2-2-1. Ndërsa me datën 03.12.2024 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues për dhënie te kontratës. **N.N.SH. " Vizion Project "- Prishtinë,**

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: - shërbim, vlera e parashikuar e kontratës: **43,500.00 €**.

Me 06.12.2024, OE N.P.N. "UNIVERS- MI", ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Më 12.12.2024, Autoriteti Kontraktues e ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 20/12/2024, OSHP ka pranuar ankesën nga OE N.P.N. "UNIVERS- MI", me nr. 2024/1250 për lidhur me aktivitetin "Mbikëqyrja profesionale e ndërtimit të QKMF në Istog dhe QKMF në Drenas" me nr. të prokurimit: 206-24-6057-2-2-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues N.P.N. "UNIVERS- MI", janë parashtruar si në vijim:

Pas vlerësimit na dërgohet – B58 njoftim mbi vendimin e AK e datës 03.12.2024, , ku shpërblehet me kontratë Operatori Ekonomik: N.N.SH Vizion Project me vlerë 27,528.87 Euro.

Po në të njëjtën datë Autoriteti Kontraktues na ka dërguar letër standarde për tenderuesin e eliminuar.

Me datën 04.12.2024 ne si Kompani kemi kërkuar qasje në dokumente zyrtare, ku qasja na është mundësuar me datë 05.12.2024 nga ora 10:00, ku edhe kemi shkuar për qasje. Gjatë kontrollimit të dokumentacionit kemi hasur në shkelje të LPP-së nga ana e AK-së.

PRETENDIMI NR.1 AK ka shkelur Nenin 1 Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla.

SQARIM : AK nuk e ka respektuar Nenin 1 (pika 1) duke e shpërblyer OE me çmim me të lartë dhe duke e dëmtuar buxhetin e shtetit në vlerë prej 11,011.55 Euro.

PRETENDIMI NR.2 AK ka shkelur nenin 56 të LPP-së – 1.1. së pari, vlerësimin të tenderëve dhe kandidatëve sipas kërkesave të kualifikimit të specifikuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit sipas paragrafit 2. të nenit 51 të këtij ligji, dhe tenderëve sipas specifikimeve teknike të kërkuara në bazë të nenit 28 të këtij ligji; 1.2 së dyti, vlerësimi i tenderëve në përputhshmëri të kriterëve të vendosura në nenin 60 të këtij ligji. AK na ka eliminuar me arsyetimin:

Kërkesa e AK-së

SQARIM : Kërkesa nga AK ka qenë e qartë që OE duhet të dorëzoj një projekt të mbikëqyrur nga sektori i shëndetësisë brenda tri viteve të fundit nga njoftimi për kontratë. Ne kemi dorëzuar një projekt të kryer nga OE Pune kryes të përfunduar me datë 02.02.2023 që e plotëson kërkesën e AK të kërkuar në njoftimin për kontratë dhe DT.

Nëse PRETENDIMI nr.2 sipas jush nuk e plotëson kërkesën e AK , ne PRETENDIMIN nr.3 ju paraqesim edhe kontratën dhe referencën e projektit tjetër nga sektori i shëndetësisë, që i përket kontratës tonë për mbikëqyrje në koncorzium me kompaninë P.M.N. SH.P.K., të listuar me nr rendor 2 në listën e projekteve të ngjashme të ngarkuar në E Prokurim.

PRETENDIMI NR.3 AK ka shkelur nenin 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtesë 1. Kur informacioni apo dokumentacioni që duhet të dorëzohet nga operatorët ekonomikë është ose duket të jetë jo i plotë ose i gabuar, ose kur mungojnë dokumentet specifike, autoritetet kontraktuese mund të kërkojnë nga operatorët ekonomikë që të dorëzojnë, plotësojnë, sqarojnë apo kompletojnë informacionin apo dokumentacionin e duhur brenda një afati të caktuar kohor, me kusht që kërkesat e tilla bëhen në përputhje të plotë me parimet e trajtimit të barabartë dhe transparencës.

2. Autoriteti kontraktues mund të ftojë operatorët ekonomik për të plotësuar apo të qartësojë certifikatat dhe dokumentet e paraqitura në pajtim me nenet 65- 71 të këtij ligji.

3. Sigurimi i informacionit që mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive.

SQARIM Ne E-Prokurim kemi të ngarkuar listën e kontratave të realizuara brenda tri viteve të fundit, ku gjithsej janë të paraqitura 3 kontrata.

Kontrata nr.2 përmban një projekt nga sektori i shëndetësisë,

Titulli: “Lot 1-Ndertimi i ambulancës në Uçe”

Numri i prokurimit: 633/021/4504/5-2-1/C481,

ku AK ka shkelur nenin 72 duke mos kërkuar informata shtesë, sepse për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të

verifikohet në mënyrë objektive.

Të bashkangjitur gjeni dëshminë e kontratës dhe referencës tonë për mbikëqyrje të komplet projekteve si dhe kontratën dhe referencën e OE Pune kryes për këtë projekt:

Kjo kontrate e këtij projekti te sektorit te shëndetësisë është e mbikëqyrrur përmes kontratës tone nr.2 e cila është ne koncorzium me kompaninë P.M.N. SH.P.K., ku te njëjtës Kompani (P.M.N. SH.P.K.), ne Lot 1 Ndërtimi i QKMF-se Istog, i është pranuar si pune e mbikëqyrrur sipas kërkesës se AK-se nga sektori i shëndetësisë

PRETENDIMI NR.4 AK ka shkelur Neni 59- Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve 2. Autoriteti kontraktues mundet që me shkrim të kërkojë nga një tenderues që të sigurojë një sqarim me shkrim mbi cilindo nga aspektet e tenderit të tij, në mënyrë që të bëhet ekzaminimi, vlerësimi ose krahasimi i tenderëve. Asnjë ndryshim material dhe asnjë aspekt i tenderit nuk duhet të kërkohen ose pranohen nga autoriteti kontraktues ose të ofrohen nga një tenderues.

Kërkesa e AK-së për projekte të ngjashme

SQARIM: OE i shpallur fitues ka dorëzuar një listë prej 9 kontratave të përfunduara, ku vetëm kontrata nr.1 dhe nr.2 kanë si aktivitet edhe mbikëqyrjen e punimeve, por kanë edhe aktivitete tjera te projektimit, dhe studimin e fizibilitetit që do të thotë se:

Kontrata nr 1 ka vlerën 162,000.00 pa TVSH

Kontrata nr 2 ka vleren 27,000.00.

Këto vlera te këtyre dy kontratave janë te përgjithësuara, dhe nuk jenë te ndara sa është vlera e projektimit, sa e mbikëqyrjes, sa e studimit te fizibilitetit.

AK ka shkelur nenin 59 pika 2 sepse është dashur te kërkojë sqarim nga OE i shpallur fitues paramasat ofertuese ne mënyrë qe te beje ekzaminimin, vlerësimin e ofertave sipas kërkesës se kërkuar ne njoftimin për kontrate dhe DT qe ka qene te ofroje mbikëqyrje ne vlere prej 55,000.00 Euro ne periudhën e shkuar 3 vjeçare.

INTERPRETIMI I AK LIDHUR ME PRETENDIMET TEK KERKESA PER RISHQYRTIM:
Bashkangjitur gjeni vendimin e refuzimit të kërkesës për rishqyrtim nga ana e AK

PRETENDIMI I AK:

SQARIMI: Sa i përket referencës tone për mbikëqyrje te kontratës : ditur se ashtu siç data e referencës se OE Pune kryes është gabim teknik, edhe data e referencës se kontratës tone ka qene gabim teknik. Për këtë ne kemi kërkuar nga Komuna e Istogut qe ta beje përmirësimin e datës, si dhe ne fund te referencës AK tek pjesa e shtojcës e ka sqaruar se ka qene gabim teknik data e refences tone te kontratës 633-019-436-221. Po i'u bashkëngjisim referencën e përmirësuar nga AK-Istog. Kurse sa i përket pretendimit se ne raportin e verifikimit teknik te OE-Pune kryes është i shënuar vetëm Lideri i Grupit te OE për mbikëqyrje P.M.N. SH.P.K. me

përfaqësues Zenun Tolaj, në e kemi bashkëngjitur kontratën për mbikëqyrje ku ceket se kontrata është në koncorzium se bashku me NPN UNIVERS MI, dhe në këtë raport të verifikimit i shënuar emri vetëm liderit të grupit

Duke u referuar pretendimeve si më sipër “N.P.N. "UNIVERS- MI", konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin, 1 Qëllimi NENI 56 i LPP-së Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave NENI 59 i LPP-së Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve NENI 60 i LPP-së Kriteret për Dhënien e Kontratës NENI 72 i LPP-së Dokumentacioni dhe informacioni shtesë PËRFUNDIM TË APROVOHET SI E BAZUAR ANKESA E OPERATORIT EKONOMIK N.P.N. UNIVERS MI lidhur me tenderin Mbikëqyrja profesionale e ndërtimit të QKMF në Istog dhe QKMF në Drenas-Lot 2, dhe lënda të kthehet në Rivlerësim AK-se i kërkohet që rivlerësimin ta bejë bazuar plotësisht si në kërkesën për rishqyrtim ku kemi ngarkuar projektin e mbikëqyrur nga sektori i shëndetësisë, që realisht me pas duhej të shpallej fitues operatori ekonomik N.P.N. UNIVERS MI

Përgjigje e AK në kërkesën për rishqyrtim: Përgjigja e Autoritetit Kontraktues në lidhje me pretendimet Ankimore të QE ankues:

Kërkesa juaj për rishqyrtim është trajtuar me mjaft vëmendje nga ZPP dhe komisioni vlerësues dhe pas shqyrtimit të pretendimeve dhe dëshmimeve të prezantuara, konstatojmë se është i pa bazuar pretendimi juaj ankimorë, kur e kontestoni arsyen e eliminimit për mos plotësimin e kriterit të Të ketë mbikëqyrur të paktën një projekt nga sektori i shëndetësisë bazuar në dëshmitë e rre poshtme.

Gjate Ri-vlerësimit të aktivitetit është shqyrtuar dokumentacioni i ofertës tuaj, pjesë e të cilës është edhe Lista e projekteve të realizuara nga ana juaj, e cila përmban 3 projekte si në tabelë:

Sa i përket projektit të prezantuar “Ndërtimi i ambulancës në fshatin Veriq” me nr. të prokurimit Numri i prokurimit: 633-22-5241-5-2-1, ky projekt është mbikëqyrur nga ana juaj në kuadër të kontratës kornizë “Mbikëqyrja e projekteve për infrastrukturë” që keni me komunën e Istogut me nr. 633-22-6174-2-2-1, në të cilën kontratë lider i grupit është kompania PMN dhe ju jeni si anëtare i grupit. Kjo kontratë kornizë 3 vjeçare ende është në implementim dhe nuk është përfunduar, nuk figuron në Listën e kontratave, në tabelën me lartë, andaj ambulanca në Veriq si pjesë e kësaj kontrate tri vjeçare nuk merret parasysh deri pas përfundimit të kontratës kornizë me komunën e Istogut.

Sa i përket mbikëqyrjes së Ambulancës në Uçë, sipas dëshmimeve të prezantuara nga ana juaj, kontrata e punëve për këtë projekt me nr. kontrate 633-021-4504-5-2-1/C481 është e nënshkruar me dt. 09.09.2021, ndërsa referencën që ju e keni prezantuar për realizimin e kontratës “Mbikëqyrja e projekteve kapitale në komunën e Istogut” me nr. 633-019-436-221/FA/36 është e datës 26.08.2021, Sipas kësaj dëshmohet se data e referencës është para datës së kontratës së punëve andaj edhe nuk mund të merret si reference që e mbulon edhe mbikëqyrjen e Ambulancës në Uçë.

Ndërsa sipas Raportit të Verifikimit të datës 17.12.2020 (si duket viti 2020 në datën e raportit mund të jete gabim teknik) në këtë raport potencohet si mbikëqyrës vetëm kompania "P.M.N." Shpk me përfaqësues Zenun Tolaj. Vullneti i AK ka qene për shpërblimin e juaj siç u kemi shpallur fitues herën e parë, meqenëse keni ofertuar me çmimin me të lire dhe e kemi arsyetuar sipas sqarimit tuaj edhe çështjen e Çmimit jo normalisht të ulet, por pas pretendimeve ankimore të ankesës në OSHP, vendimit të OSHP-se nr. 0772 që e ka kthyer lenden në rivlerësim, është bërë rivlerësimi dhe sipas sqarimeve me lartë janë evidentuar defektet e lartcekura.

Duke u mbështetur në neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me datë 24.12.2024 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 1250/2024, ndërsa me datë 01.01.2025 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2024/1250 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK nuk pajtohet rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtues, ndërsa OE nuk ka dhënë përgjigje rreth raportit të ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marrë parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritator lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE N.P.N. "UNIVERS- MI", - eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2024/1250 ka vlerësuar si në vijim:

PËRSHKRIMI I ANKESËS

Ankesa i drejtohet Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP) dhe është paraqitur nga N.P.N. UNIVERS MI kundër Autoritetit Kontraktues (AK) për tenderin "Mbikëqyrja profesionale e ndërtimit të QKMF në Istog dhe QKMF në Drenas – Lot 2." Ankuesi pretendon se procesi i tenderimit ka pasur shkelje të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) dhe kërkon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Ankuesi argumenton se AK ka shpërblyer një Operator Ekonomik (OE) me çmim më të lartë, duke shkaktuar dëm financiar për buxhetin e shtetit dhe duke eliminuar padrejtësisht N.P.N. UNIVERS MI, ndonëse ky i fundit përmbushte të gjitha kriteret e përcaktuara. Gjithashtu, ankuesi thekson se AK ka shkelur parimet e transparencës dhe barazisë, duke mos marrë parasysh dokumentacionin e vlefshëm dhe duke mos kërkuar informata shtesë për të sqaruar pretendimet.

Ankesa përmban katër pretendime kryesore lidhur me shkelje të ndryshme të dispozitave të LPP-së, përfshirë shpërblimin e padrejtë të OE-së fitues, eliminimin e padrejtë të UNIVERS MI, mosrespektimin e kërkesave për dokumentacion shtesë dhe dështimin për të bërë një ekzaminim të drejtë dhe të plotë të tenderëve.

Në përfundim, UNIVERS MI kërkon që lënda të rivlerësohet duke marrë në konsideratë dokumentacionin e dorëzuar prej tyre dhe të shpallet si OE fitues. Ankuesi gjithashtu kërkon kompensim për dëmet materiale të shkaktuara nga shkeljet e AK, përfshirë humbjen e kontratës, shpenzimet për përgatitjen e tenderit dhe dëmtimin e reputacionit të kompanisë.

ANALIZA E EKSPERTIT SHQYRTUES

Përgjigje në pretendimin ankimor 1:

Pas shqyrtimit të pretendimit ankimor dhe analizimit të të gjithë dokumentacionit të dorëzuar nga operatori i rekomanduar për kontratë, eksperti shqyrtues konstaton se, në kontekstin e pretenduar nga ankuesi, AK – Ministria e Shëndetësisë nuk ka bërë shkelje të Nenit 1 të LPP-së. Në përgjigjet e pretendimeve ankimore të mëposhtme, vërehet se ankuesi ka dorëzuar një ofertë të papërgjegjshme, prandaj nuk mund të konsiderohet se është bërë shpërdorim i burimeve publike.

Përgjigje në pretendimin ankimor 2:

Në dokumentacionin tenderik, ankuesi ka paraqitur edhe një kontratë tjetër, “Ndërtimi i ambulancës në fshatin Veriq”, por ky projekt nuk bën pjesë në listën e dorëzuar nga vet OE-ja dhe për këtë arsye nuk mund të konsiderohet. Eksperti shqyrtues ka analizuar me kujdes pretendimin ankimor dhe ka konstatuar se, bazuar në dokumentet e dorëzuara, ankuesi nuk ka përmbushur kërkesën specifike për një projekt nga sektori i shëndetësisë. Për më tepër, projekti “Ndërtimi i ambulancës në fshatin Veriq” nuk mund të merret në konsideratë pasi nuk figuron në listën e dorëzuar nga vet OE-ja.

Po ashtu, eksperti shqyrtues nuk ka gjetur se AK ka vepruar në kundërshtim me Nenin 60 të LPP-së. Eliminimi i ankuesit është i bazuar dhe në përputhje me kërkesat e përcaktuara në njoftimin për kontratë dhe dokumentacionin përkatës, pasi dokumentacioni i dorëzuar nuk përmbushte kriteret minimale për dhënien e kontratës, përfshirë mungesën e një projekti nga sektori i shëndetësisë dhe mungesën e dëshmive për mbikëqyrjen e projekteve në përputhje me vlerën minimale të kërkuar.

Përgjigje në pretendimin ankimor 3:

Eksperti shqyrtues ka analizuar kërkesën lidhur me listën e kontratave të ngjashme në mbikëqyrjen e projekteve, në vlerë të përgjithshme jo më pak se 55,000.00 euro, gjatë periudhës së shkuar 3 (Tre) vjeçare duke filluar nga data e Njoftimit për Kontratë, ku kërkohet të paktën një projekt nga sektori i shëndetësisë. Në këtë listë, OE nuk ka prezantuar asnjë projekt nga sektori i shëndetësisë. Projekti, të cilit ankuesi i referohet, nuk bën pjesë në listën e kontratave dhe nuk mund të konsiderohet se projekti “Ndërtimi i ambulancës në fshatin Veriq”, me nr. prokurimi: 633-22-5241-5-2-1, është pjesë e projektit të listuar nr. rendor 2 “Mbikëqyrja e projekteve kapitale” me nr. prokurimi: 633-19-436-2-2-1. Të dy projektet dallojnë me titull dhe numër të prokurimit dhe vërehet se janë projekte të ndryshme. Eksperti shqyrtues po ashtu nuk ka gjetur se AK ka bërë shkelje të Nenit 72 të LPP-së. Kjo mbështetur në nenin 10.1 të Udhëzuesit Nr. 001/2023 për Prokurimin Publik, i cili qartëson se kur duhet të kërkohet sigurimi i informacionit që mungon. Shih në vijim shembullin e ofruar nga UPP-së:

Problemi Si të veprohet? Neni i LPP-së

Lista e kontratave të realizuara e dorëzuar nuk përmbush kërkesat minimale të vlerës se përcaktuar Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm 69

Përgjigje në pretendimin ankimor 4:

Pas shqyrtimit të pretendimit ankimor dhe dokumentacionit të dorëzuar, si dhe analizës së kontratave të dorëzuara nga operatori i rekomanduar për kontratë, eksperti shqyrtues konstaton se AK – Ministria e Shëndetësisë ka dështuar të sigurojë një ekzaminim dhe vlerësim të drejtë të tenderëve, siç kërkohet nga Neni 59 i LPP-së.

Lista e kontratave të dorëzuara përmban këto mangësi:

Kontrata Nr. 1: Përfshin hartimin e projekteve dhe mbikëqyrjen gjatë periudhës së defekteve, por nuk përfshin mbikëqyrje aktive të projekteve ndërtimore, siç kërkohet në dokumentacionin e tenderit. Për më tepër, nuk ka ndarje të qartë të vlerës së mbikëqyrjes nga aktivitetet e tjera.

Kontrata Nr. 2: Përfshin mbikëqyrje të punimeve ndërtimore, por vlera totale prej 23,700.00 euro është shumë më e ulët se pragu minimal prej 55,000 euro për aktivitetet e mbikëqyrjes. Gjithashtu, kjo kontratë nuk lidhet me sektorin e shëndetësisë.

Kontratat e tjera: Fokusohen kryesisht në aktivitete të projektimit dhe studimeve të fizibilitetit, pa dëshmi të qartë për mbikëqyrje ndërtimore. Asnjë nga këto kontrata nuk përmbush kriterin për të paktën një projekt nga sektori i shëndetësisë.

Bazuar në shqyrtimin e dokumenteve të dorëzuara, asnjë nga kontratat e listuar nga OE nuk përfshin qartësisht një projekt të lidhur me sektorin e shëndetësisë.

Kërkesa e Autoritetit Kontraktues për të pasur të paktën një kontratë nga sektori i shëndetësisë është një kriter specifik dhe i detyrueshëm. Megjithatë, kontratat e paraqitura fokusohen kryesisht në projektimin, mbikëqyrjen e përgjithshme të ndërtesave publike ose aktivitete të tjera si hartimi dhe studimet e fizibilitetit, pa lidhje të drejtpërdrejtë me projekte nga sektori i shëndetësisë, gjë që e bën të pamundur verifikimin e përmbushjes së pragut minimal prej 55,000.00 euro. Për më tepër, AK nuk ka kërkuar sqarime shtesë për të adresuar këtë paqartësi, duke lejuar shpalljen e fituesit të një OE-je që nuk përmbushte kërkesat minimale.

PËRFUNDIMI

Ankesa e operatorit ekonomik konsiderohet pjesërisht e bazuar. Eksperti shqyrtues konstaton se Autoriteti Kontraktues (AK) ka vepruar në përputhje me ligjin për pretendimet ankimuese 1, 2 dhe 3. Megjithatë, për pretendimin 4, AK nuk ka siguruar një ekzaminim të drejtë dhe transparent të tenderëve, siç kërkohet nga Neni 59 i Ligjit për Prokurimin Publik (LPP). Rekomandohet që ankesa për pretendimin ankimor 4 të pranohet si e bazuar dhe lënda të kthehet për rivlerësim, duke respektuar plotësisht kërkesat e përcaktuara në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli Shqyrtues duke i analizuar shkresat e kësaj lënde dhe veprimet e ndërmarra nga palët, deklaratat e tyre dhe provat e administruara gjatë rrjedhës së këtij aktivitetit të prokurimit, konsideron se gjetjet e ekspertëve shqyrtues dhe mendimet e tij lidhur me këtë lëndë janë pjesërisht të pranueshme.

Vlen të theksohet fakti se për Panelin Shqyrtues, konstatimet dhe rekomandimet e ekspertëve shqyrtues nuk janë të detyrueshme, por shërbejnë vetëm si një provë në mesin e të gjitha provave tjera që vlerëson në secilën lëndë veç e veç. Paneli Shqyrtues vendos në mënyrë të pavarur, objektive dhe me kujdesin e duhur profesional duke mbrojtur gjithmonë interesin e publikut përmes LPP dhe legjislacionit sekondar në fuqi për prokurimin publik.

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit dhe konsideron se Autoriteti Kontraktues gjatë ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të ofertave ka vepruar në përputhje me LPP në fuqi.

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova Raportin e Ekspertit Shqyrtues, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtrirat dhe dokumentet e operatorit ekonomik ankues dhe operatorit ekonomik fitues, shkresat dhe dokumentet e Autoritetit Kontraktues përfshirë edhe përgjigjen e AK me rastin e kundërshtimit të raportit të ekspertizës

Ankuesi në ankesën e tij, atakon AK se ka vepruar në kundërshtim me dispozitat ligjore duke paraqitur katër (4) pretendime ankimore, në tri (3) prej tyre atakon AK me rastin e eliminimi të ofertës së tij nga ky aktivitet i prokurimit. Paneli shqyrtues lidhur me këto pretendime ankimore i

mbështet plotësisht konstatimet e ekspertës shqyrtuese e cila ka vlerësuar drejtë dhe ka paraqitur gjendjen reale të ofertës së OE ankues. Pretendimi kryesor i ankuesit është edhe kërkesa e DT për të cilën ankuesi nuk e ka plotësuar lidhur me listën e kontratave të realizuara të ngjashme në mbikëqyrjen e projekteve dhe paneli shqyrtues njëjtë sikurse eksperti shqyrtues duke u bazuar në kërkesën/kriterin e Njoftimit për Kontratë dhe Dosjes së Tenderit mund të konstatohet se ky pretendimin ankimor është i pabazuar dhe AK me të drejtë ka eliminuar ofertën e tij/saj nga ky aktivitet i prokurimit ngase i njëjti nuk ka ofertuar konform kërkesave të DT.

Ankuesi në ankesën e tij/ ka paraqitur edhe pretendim ankimor duke atakuar AK se ka bërë shkelje të dispozitave ligjore me rastin e përzgjedhjes së OE të rekomanduar për kontratë duke aluduar se as OE i rekomanduar për kontratë nuk e plotëson kërkesën e AK sa i përket listës së kontratave të realizuara. Eksperti shqyrtues evidenton disa kontrata të cilat përmbajnë mangësi dhe për të cilat i propozon Panelit Shqyrtues që lënda të kthehet në ri-vlerësim, ngase AK nuk ka kërkuar sqarime shtesë.

Paneli Shqyrtues pas administrimit të të gjitha provave, e posaçërisht shkresës e AK në përgjigje të raportit të ekspertit shqyrtues e datës 08.01.2025, e cila gjendet në platformën elektronike ku ka paraqitur kundërshtime duke deklaruar se: *“Fillimisht kërkojmë mirëkuptimin e juaj për vonesën në përgjigje, meqenëse ishte koha e pushimeve të fundvitit, ndërsa sa i përket rekomandimit në ekspertizë, si AK-MSh nuk pajtohem me ekspertizën dhe rekomandimin e ekspertës se asnjë nga kontratat e listuara nga OE nuk përfshin qartësisht një projekt të lidhur me sektorin e shëndetësisë, bazuar në dokumentacionin e ofertës, të lista e projekteve, projekti i pare në liste me përshkrimin e me poshtëm, në kuadër të projekteve përbërëse të kësaj kontrate janë edhe dy objekte nga lamia e shëndetësisë:*

8. Ambulanta në Prekoc , Novobërdë, në vlerën totale me shtesa 42,972.17 euro, e pranuar me datën 26.04.2024

11. QKMF “ Kolonia e vjetër “ Novobërdë, në vlerën totale me shtesa 55,099.77 euro, e pranuar me datën 26.04.2024

Kontrata nr. 1 nga lista me titullin: Hartimi i Projekteve të Detajuara , Specifikimet Teknike duke përfshirë Dizajnin , Mbikëqyrjen , Komisionimin dhe Mbikëqyrjen e Menaxhimit gjatë Periudhës së Përgjegjësisë së Defekteve, për Rinovimin e Ndërtesave për të sigurim grumbulluar Eficiente të Energjisë - Loti 3 (për 14 objekte publike në komuna të ndryshe të Kosova).”

Paneli Shqyrtues në këtë rast vlerëson se duke u bazuar në këtë provë të autoritetit kontraktues konsideron se AK ka vepruar drejtë me rastin e vlerësimit të ofertave ngase, ngase OE i rekomanduar për kontratë ka paraqitur në ofertën e tij listën e kontratave të ngjashme të realizuara konform kërkesës së DT dhe Njoftimit për Kontratë. MSH njëherit në këtë përgjigje ka paraqitur edhe kontratat e nënshkruara të cilat konfirmojnë edhe vlerat për objektin nr. 8 dhe 11 që e tejkalojnë vlerën prej 55,000.00 euro.

Kështu që, Paneli Shqyrtues nuk mund ta mbështesë tërësisht mendimin e ekspertit shqyrtues që lënda të kthehet në ri-shqyrtim, dhe me të drejtë e mori në konsideratë përgjigjen e dhënë të AK

duke u bazuar edhe në opinionin e KRPP nr. 11 të datës 09.06.2023, ku konsideron se “KRPP nuk mund të tejkalojë autorizimet që i janë dhënë me ligj dhe të përcaktoj se cilat furnizime, shërbime apo punë konsiderohen të ngjashme me lëndën e kontratës së specifikuar nga AK në Dosjen e tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë. Një përcaktim i tillë është kompetencë ekskluzive e AK-së. Pra Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit me ndihmën e njësisë së kërkesës dhe/ose ekspertëve të kësaj fushe mund të përcaktojnë shërbimet e ngjashme. Në kë rast si orientim i mirë për përcaktimin e furnizimeve, shërbimeve apo punëve të ngjashme mund të shërbejnë edhe kodet e përcaktuara në FPP ku aktualisht janë të publikuara 8.323 kode të FPP në Platformën Elektronike të Prokurimit Publik.”

Andaj, Paneli Shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe përgjigjen e AK të dhënë karshi raportit të ekspertizës, vlerëson se ankesa e Operatorit Ekonomik duhet të aprovohet si e pjesërisht e bazuar. por e cila është e pamjaftueshme që të anulohet vendimin e AK. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur të mbetet në fuqi Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues Ministria e Shëndetësisë, lidhur me aktivitetin e prokurimit, me titull “Mbikëqyrja profesionale e ndërtimit të QKMF në Istog dhe QKMF në Drenas” me numër të prokurimit 206- 24-6057-2-2-1.

Paneli Shqyrtues vlerëson se AK duke u bazuar në nenet 59 dhe 60 të LPP ka rekomanduar OE me ofertën më të lirë të përgjegjshëm vendim ky i cili është nxjerrë nga një komision i vlerësimit i cili supozohet të jetë profesional konform nenit 59 par. 1 të LPP-së, ku thote: “Të gjithë anëtarët e Komisionit Vlerësues marrin përgjegjësi të plotë individuale për vlerësimin e kryer të ofertës”, atëherë bazuar në të lartcekurat, Paneli Shqyrtues konsideron se veprimet dhe aktet e AK, lidhur plotësimin ose jo të kushteve të përshkruara si më sipër dhe pohimet ankimore në këtë rast përbejnë bazë të mjaftueshme që të mbetet në fuqi vendimi i AK.

Paneli Shqyrtues thekson se secili autoritet kontraktues (në nivelin qendror dhe lokal) gëzon autonomi në planifikimin e prokurimit (neni 8) dhe në përcaktimin e nevojave që duhen përmbushur (neni 9), natyrisht në pajtim me kapacitetin buxhetor dhe se AK në rastin konkret ka pasur të drejtë të vendos po ashtu edhe për OE të rekomanduar për dhënie të kontratës bazuar edhe në neni 24 paragrafi 2 të LPP cituar “Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj”.

Përfundim –

Bazuar në kompetencat e OSHP të parapara me nenin 105, lidhur me nenin 106 të LPP, Paneli Shqyrtues vuri në zbatim mes tjerash dhe nenin 103 të Ligjit të cituar sipas të cilit të gjitha palët e interesuara do të kenë qasje të barabartë në procedurat për shqyrtimin e prokurimit dhe në mjetet juridike dhe se, asnjë vendim i OSHP, nuk do të merret ose bëhet në mënyrën me të cilën diskriminohet në të mirë ose në dëm të një pjesëmarrësi në procedurë ose të një personi ose ndërmarrje tjetër.

Paneli sqaron se përveç nenit 1,7,27,28 dhe 59 të Ligjit për Prokurim Publik, është e rëndësishme të theksohet se të gjithë ofertuesit janë të vetëdijshëm për procesin e aplikimit dhe dorëzimit të dokumentacionit në përputhje me dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë. Kanë përvojë të mjaftueshme në këtë fushë dhe janë pjesëmarrës të vazhdueshëm nëpër tendere që publikohen në Republikën e Kosovës, duke kontribuar në një aplikim të ndershëm dhe të drejtë për të gjithë.

Kjo siguron një garë të barabartë dhe të drejtë për të gjithë ofertuesit dhe shmang ndikimin në prolongimin e procedurave të prokurimit, me "kërkesa për sqarime të vazhdueshme nga ofertuesit" për dokumentacionet të cilat vazhdimisht i procedojnë për aplikime në ofertat e tyre. Andaj, paneli sqaron se në këtë rast përgjegjësia bie mbi ofertuesin, i cili tenderon për të fituar. Sepse është evidente dhe e njohur për të gjithë, se në çdo rast të njoftimit për kontratë, secili ofertues i cili nuk posedojnë "pajisjet adekuate" apo "kërkesa që mund të jenë diskriminuese apo të paqarta", do duhej që në fazën paraprake (para ofertimit), ti kundërshtoj të njëjtat apo eventualisht të parashtrojë pyetje apo të kërkojë sqarime nga AK. Në këtë kontekst edhe sipas gjyqimit të pavarur të këtij paneli, AK por as OE, nuk duhet të thirren në dispozita nënligjore që të kërkojë sqarime shtesë për dokumentacionin e ofertuesve në çdo rast, pasi siç u sqarua si më sipër të gjithë ofertuesit janë të vetëdijshëm për detyrimet dhe procedurat e aplikimit nëpër tenderë.

Kërkesa e ankuesit për plotësimin e dokumentacionit nuk duhet të shihet si një arsye e vlefshme për të ndërhyrë në procesin e prokurimit në mënyrë të pamjaftueshme të arsyeshme dhe duke ndërhyrë në punën e AK pa ndonjë provë dhe të rrezikoj edhe përmbushjen e nevojave të AK dhe rrezikimin e implementimit të kontratës. Secili e sidomos autoriteti kontraktues duhet të siguron që procedurat e prokurimit të mbeten efikase dhe të përmbushin qëllimin e tyre të sigurimit të kontratave publike në mënyrë të rregullt dhe të drejtë për të gjitha palët e interesuara.

Po ashtu, vlenë të theksohet edhe fakti se neni 72 i LPP, nuk i vë karakter detyrimi AK që të kërkojë sqarime, ngase ka shprehjen "mund". Paneli sqaron se po ashtu se në vështrim të kërkesave të autoritetit kontraktues të cilat precizohen në dosjen e tenderit dhe si të tilla bëhen publike për të gjithë ofertuesit eventual, secili duhet të udhëhiqet nga parimi i kujdesit në përmbushjen e kushteve formale në kohë dhe brenda afatit, kurse kthimi i një aktivitetit të prokurimit në mungesë të provave jo kontestuese nuk ofron bazë ligjore për ri-vlerësim eventual të tij dhe nuk është në harmoni me nenin 1 dhe nenit 7 të LPP. Në fakt synimi i këtij aktiviteti të prokurimit i referohet dhe nenit 104 paragrafi 4 i LPP, sipas të cilit në ndërmarrjen e masave të përcaktuara në këtë Pjesë IX, OSHP duhet (i) të veprojë sa më shpejtë që të jetë e mundshme, të veprojë në mënyrë proporcionale me shkeljen e pretenduar ose çështjen për të cilën është paraqitur ankesa dhe të marrë për bazë pasojat e mundshme të veprimeve ose masave në të gjitha interesat që mund të dëmtohen, duke përfshirë interesin publik.

OSHP niset gjithnjë nga fakti se çdo AK (në çdo nivel) gëzon pavarësinë e plotë në ushtrim e kompetencave dhe caktimin e nevojave në harmoni me kapacitetet buxhetore. Prandaj nisur nga të lartcekurat dhe duke i administruar me kujdes të gjitha provat e bashkëngjitura në shkresat e kësaj lënde, Paneli Shqyrtues ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi i bindur se ka aplikuar

zgjidhjen e duhur konform legjislacionit në fuqi dhe natyrës së çështjes në rastin konkret duke e konsideruar po ashtu të drejtë dhe të arsyeshme edhe lejimin e mjeteve të deponuara në emër të tarifës ankimore, përfshirë dhe operatorët ekonomik të cilët janë provuar nga qasja në dokumente.

Bazuar në të lartcekurat, Paneli shqyrtues vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi, në pajtim me nenin 117 të LPP. Për pikën III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - MINISTRIA E SHËNDETËSISË**
- **OE - N.P.N. " UNIVERS- MI "**
- Arkivës së OSHP-së: